

## ROMANI DHE POPULLARITETI I TIJ NË PERIUdhËN VIKTORIANE

Suzana IBRAIMI MEMETI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Gjuhë dhe letërsi angleze – Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës  
e-mail: [suzana.ibraimi@unite.edu.mk](mailto:suzana.ibraimi@unite.edu.mk)

---

### Abstrakt

Letërsia e periudhës viktoriane ishte e kushtëzuar nga kuadri i përgjithshëm ideologjik si dhe nga disa faktorë të tjerë. Shkrimtarët e kishin prejardhjen më të shpeshtë të herëve nga borgjezia apo mikroborgjezia dhe në përgjithësi ishin besnikë ndaj pikëpamjeve konvencionale dhe të ndërlikuara, shumë më tepër sesa inteligjenca krijuese e vendeve të tjera të Evropës. Shumica e shkrimtarëve kishte parasysht shijen e publikut të cilit i drejtohej dhe të cilin e përfaqësonte. Me këtë rast, për popullaritetin e veprave letrare një rol të veçantë kishte si kritika letrare ashtu edhe numri i madh i revistave letrare. Ndër gjinitë letrare, poezia me autoritetin e saj vazhdoi për njëfarë kohe të mbante vend parësor, por jo edhe me përhapjen e veprave midis lexuesëve të shumtë. Tashmë, vendin e parë e kishte zënë romani. Romani në këtë periudhë kishte ndërtuar disa norma të veçanta të cilat mbetën të pandryshueshme deri në fund të shekullit.

**Fjalë kyçe:** Periudha viktoriane, proza letrare, roani viktorian, klasa shoqërore, vlera artistike.

---

### Hyrje

Epoka viktoriane konsiderohej si epoka më e madhe e romanit anglez gjatë viteve 1837-1901. Krijimi i kushteve të reja shoqërore, ekonomike dhe politike e ndihmoi zhvillimin e romanit anglez. Vlen të thuhet se romani viktorian ishte i lidhur ngushtë me kushtet e popullit anglez në një periudhë të urbanizimit dhe të industrializimit të hovshëm. Nën kushte të tilla, kishte shpresë se romancierët do ta përshkruanin jetën me besnikëri, me ç'rast duhet veçanërisht të përdornin edhe dokumentacionin. Si pasojë e kësaj pikëpamjeje, romancierët viktorianë u shkëputën nga tradita romantike dhe u orvatën përmes veprave të tyre që të luanin rolin jo vetëm të kritikëve shoqërorë po edhe të reformatorëve politikë e moralë. Në këtë mënyrë, romani viktorian u bë “një burim i rëndësishëm i mësimin dhe udhëzimit moral dhe i kritikës shoqërore” (Pollard,15-20). Boris Fordi në librin e tij “The New Pelican Guide to English Literature: from Dickens to Hardy” ka shkruar: “Misioni i romancierëve viktorianë ishte mjaft i limituar. Kushtet shoqërore i detyronin që të përgatisnin një qasje pragmatike. Ekzistonte një kërkesë e qartë për veprat e tyre. Aso kohe, kishte një sërë detyrash për të bërë dhe një mori kauzash për të mbrojtur. Kjo epokë kërkonte inkurajimin e patriarkatit dhe matriarkatit, kështu që shkrimtarët e patën parasysht si predikuesit ashtu edhe burrat e shtetit” (68).

Nga ky citat shihet qartazi se romancierët viktorianë nuk patën mundësi që t’i përpunonin dhe t’i zbulonin veprat e tyre ose të përzgjidhnin tema dhe motive jashtë sferës së tyre të detyrës të imponuara nga kushtet shoqërore dhe politike. Duhet thënë se romancierët viktorianë, nga një anë ishin të detyruar që shkrimet e tyre t’i shkruanin për dobisë dhe të politikës, por nga ana tjetër ata duhet të respektonin edhe fenë, etikën dhe moralin.

## **Teksti kryesor**

Vitet pesëdhjetë, gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë të shekullit XIX sollën zgjerimin dhe begatimin e temave të romanit. Proceset letrare të realistëve të shquar të kësaj periudhe, të Dikensit, Thekërit, Eliotit dhe të tjerëve, nuk mund të pengoheshin me kurrfarë rregullash. Romancieri, sipas dëshirës dhe vullnetit të tij, e sjell rrëfimin e tij të gjërë ose të ngjeshur, ai po kështu paraqet fakte, ia rrëfen lexuesit sekretet e personazheve dhe heronjve të tij, i gjykon sjelljet dhe aktet e tyre dhe i komunikon pikëpamjet e tij nëpërmjet komenteve të autorit. Formimi i karakterit që nga rinia dhe sjellja në moshën e pjekurisë përbën strumbullarin për realizimin dhe zhvillimin e subjektit të veprës. Me këtë rast, shkrimtarët ende përkujdesen për implikimet morale të veprës së tyre. Ata edhe më tutje sillen në kuadrin e etikës konvencionale; dilemat e heronjve dhe të heroinave të tyre flasin për paragjykimet e autorit, prandaj shpeshherë mungon dimension i gjithënjëzësor (Long, 452-456).

Shkrimtarët me orientim social përpiqen t'ia komunikojnë lexuesit se ideja e bashkëpunimit në mes klasave shoqërore është më e mirë sesa konflikti midis tyre. Në vitet tetëdhjetë, romancierët interesohen për një problematikë tjetër. Kjo ishte pasojë e ndryshimeve që kishin ndodhur në dekadat e mëparshme. Ishte zhdukur frika që ekzistonte se godina shoqërore mund të shembej në luftën qytetare. Ajo situatë e nderë nuk ekzistonte më. Lëvizja punëtore u përtëri dhe u përforcua, mirëpo sindikatat synonin që të siguronin qëllime ekonomike. Kishin ndryshuar edhe shumë gjëra të tjera: klasa punëtore e siguroi me ligj të drejtën e votimit, të drejtën për shkollim pa pagesë dhe të drejtën e bashkëpunimit legalisht me sindikatat. Vendet koloniale ofronin mundësi ose perspektivë për ata të cilët ishin të pakënaqur me kushtet në atdhe. U zgjerua rrjeti i universiteteve edhe në qytet industriale ku shkolloheshin dhe formoheshin kuadrin e larta të popullit, të privuar nga paragjykimet aristokrate që sundonin në universitetet e vjetra të Oksfordit dhe të Kembrixhit. Në këtë mënyrë, Anglia u bë një vend i fuqishëm me një klasë të fuqishme të mesme dhe me klasa të tjera. Jo vetëm borgjezia e lartë, por edhe mikroborgjezia u bënë faktor ndikues në shoqëri, gjë që ndikoi në opinionin publik dhe në klimën shoqërore dhe kulturore (Sampson, 762-766).

Ndërkaq, në katër dekadat e fundit të shekullit XIX ekzistonte një pakënaqësi me frymën filistine apo hipokrite që i imponohej artit. Së këndejmi, disa shkrimtarë u tërhoqën nga opinionin publik dhe u mbyllën në botën e artit të tyre. Sa i përket kësaj kthese, dolën në shesh edhe pasuesit e Esteticizmit apo “artit për art,” përfaqësuesi kryesor i të cilëve ishte Oskar Uajldi. Mirëpo, as ata shkrimtarë të cilët si Tomas Hardi interesoheshin për problemet shoqërore, tani nuk i drejtoheshin më kombit ashtu siç bënte dikur Çarlz Dikensi. Xhorxh Elioti dhe Tomas Hardi ishin shkrimtarë shumë të respektuar dhe të njohur, por nuk ishin shkrimtarë që lexoheshin më së shumti. Ata kishin një qëndrim elitare dhe e konsideronin veten se duhet të qëndronin mbi problemet e përditshme shoqërore dhe politike, prandaj nuk përziheshin as në polemikat e shumta dhe të ashpra. Pikërisht me Xhorxh Eliotin fillon gradualisht ai anashkalim i shkrimtarit nga lexuesi, gjë që do të bëhet karakteristikë e shekullit XX. U morr vesh, paralelisht me lulëzimin e romanit të mirëfilltë, u krijuan edhe një mori romanesh “komerciale.”

Pak a shumë, deri në vitet e tetëdhjeta ekzistonte njëfarë mase: dihej pa dyshim se çfarë ishte e mirë dhe çfarë ishte e keqe. Mirëpo, pas kësaj sigurie, pasoi një dilemë. Meqë u rrezikuan të gjitha vlerat kur shkenca i shembi mitet krishtere. Zgjerimi i perandorisë, nga ana tjetër, i zgjeroi edhe horizontet e njerëzve; ndërkohë njerëzit kishin mësuar edhe për kulturat dhe filozofitë e tjera. Të gjitha këto patën ndikim në romancierët viktorianë, të cilët i ishin shporrur mendjengushtësisë provinciale që kishin pasur një numër i romaneve viktoriane. Tani shkrimtarët nuk janë aq të sigurt se çfarë përgjigjesh t'u japin dilemave të cilat i shtjellojnë në subjektet e romaneve të tyre. Në të shumtën e rasteve ata e linin pyetjen pa përgjigje ose ofronin ndonjë sqarim të zakonshëm por jo definitiv. Edhe mesazhi i romanit bëhet problematik, ndërsa shtresa mendore e tij në strukturën e romanit bëhet më e thellë dhe më e ndërlikuar.

Shkrimtarët më të shquar dhe më autoritativë i drejtoheshin lexuesit të edukuar, të shkolluar dhe inteligjent, i cili do të ishte në gjendje ta përcillte dhe ta kuptonte artin e tyre të ndërlikuar. U kishte ardhur fundi romaneve me format e teknikat tradicionale të mesit të shekullit XIX. Tani romani modern ishte i komponuar me një përmbajtje dhe teknikë komplekse. Përgjithësisht këto romane ishin më të shkurtra, por shumë më të ngjeshura. Tani shkrimtarët e përpunonin, e përimitonin dhe shestonin çdo paragraf dhe çdo kapitull, u shmangeshin digresioneve dhe komenteve të autorit. Natyrisht, shkrimtarët nuk i komentonin veprat, sepse situatën që e shqyrtonin në roman e konsideronin si neutrale, prandaj nuk e impononin mesazhin moral. Me fjalë të tjera, tani shkrimtarët nuk e marrin më rolin e krijuesit dhe gjykuesit të gjithëdijshëm. Përveç kësaj, besueshmëria në roman ende konsiderohej e dëshirueshme. I inkurajuar nga zhvillimi i shkencave të ndryshme, romancieri filloi të shtjellonte tema dhe çështje të cilat deri atëherë nuk i përkisnin veprimtarisë letrare dhe artistike; ai e zbulon dhe e shpjegon anën psikologjike të sjelljes njerëzore. Në të njëjtën kohë, realizmi si parim i formësimit artistik, ishte nxitur edhe më tepër nga zhvillimi i shkencave. Fjala vjen, psikanaliza në fillim të shekullit të ri e krijoi bazën për eksperimente surrealistike në romanin e “përroit të ndërgjegjes” (stream-of-consciousness).

Në këtë periudhë, mendimi shkencor dha shkas dhe mundësi që të krijohesh drejtimi letrar i quajtur natyralizëm. “Romani eksperimental” i shkrimtarit francez Emil Zola, është një përpjekje që me anë të vëzhgimit, analizës dhe kritikës shoqërore të realitetit të sqarohet prejardhja e pastaj edhe kuptimi i dukurive shoqërore. Si të ishte shkencëtar, Zola i shënonte mbresat e shkurtra të jetës, pastaj i përfshinte dhe i përpunonte në romanet e tij. Mirëpo, Zola ishte shkrimtar me një imagjinatë të gjallë krijuese, kështu që në romanet më të mira të tij mbisundon imagjinata mbi dokumentet. Të metat dhe vlerat e romanit natyralist, vërehen edhe te disa romancierë anglezë.

Në shenjë reagimi ndaj natyralizmit dhe realizmit kritik në tërësi, disa shkrimtarë i përvishen hetimit psikologjik të personazheve, të cilët i analizojnë në hollësi. Ndër këta shkrimtarë spikatet Xhorxh Meredithi dhe Henri Xhejmsi. Por, ka edhe shkrimtarë të cilët nuk janë të kënaqur me analizën e hollësishme psikologjike të personazheve, por si Robert L. Stivensoni dhe Oskar Uajldi depërtojnë në ndërdijen e personazheve. S'është çudi që pothuajse të gjithë këta shkrimtarë tregojnë një vëmendje të veçantë për perfeksionimin e formës dhe të stilit; disa ndër ta nuk ishin

të kënaqur as me romanin tradicional viktorian; ata i kushtonin vëmendje jashtëzakonisht të madhe fuqisë dhe artit të fjalës. Në fazën e fundit të viktorianizmit vërehet edhe ndikimi i simbolizmit në fabulën dhe në stilin e romanit.

### **Përfundime**

Romani i kësaj periudhe, siç e kemi thënë tashmë, u bë gjini letrare më e rëndësishme se poezia. Pikërisht në fushën e romanit, anglezët në këtë periudhë kanë krijuar vepra të cilat janë bërë pjesë e letërsisë botërore. Disa ndër romancierët e kësaj periudhe fituan famë botërore që kur ishin të gjallë dhe ndikuan në letërsi të tjera. Poetët e kësaj periudhe nuk kanë arritur ndonjë famë të lartë, ndonse Tenisoni dhe Brauningu kanë qenë të popullarizuar edhe në Evropë, ndoshta edhe për hir të autoritetit të Britanisë së Madhe, e cila aso kohe ishte fuqia e parë botërore. Mirëpo, me romanin, puna është ndryshe: Dikensi depërton në Evropë brenda një kohe të shkurtër ndërsa Thekëri, Xhorxh Elioti edhe disa romancierë të tjerë vazhduan të përkthehen deri në fund të shekullit XIX.

Arsyet janë të shumta. Një ndër arsyet kryesore është vlera artistike e autorëve, por ndoshta është me rëndësi të theksohet se romani anglez në mesin e shekullit XIX, ishte bërë gjini dominante në letërsi. Njëherësh përveç kësaj, romani dhe tregimi si gjini më komunikative të letërsisë, prej asaj kohe e zënë vendin e parë në krijimtarinë letrare. Megjithëse poezia kishte pasur dikur vendin e parë në letërsi, ajo tani konsiderohej si gjini letrare e dorës së dytë. Ç'është e vërteta, romancieri i kësaj periudhe konsiderohej më tepër si një lloj argëtuesi i lexuesit.

Një numër i konsiderueshëm i romancierëve anglezë, e ndër ta edhe Dikensi në fazën e parë të veprimtarisë së tij, spontanisht e pranuan funksionin argëtues të romanit. Prandaj dhe Dikensi në këtë fazë të krijimtarisë shkruante për ta zbavitur publikun lexues pa i dhënë rëndësi parësore strukturës artistike të veprës. Kjo kishte një pasojë të mirë, meqë të gjithë shkrimtarët përpiqeshin të shkruanin në mënyrë interesante dhe dëfryese, meqë tema interesante ishte gjithmonë një lloj vlere e veçantë e romanit. Mirëpo, në këtë rast vlen të ceket se një metodë e këitill kishte edhe pasoja jo aq të mira, kompozicionin mekanik, senzacionin, cektësinë dhe pikëpamjet konvencionale dhe tradicionale ndaj botës. Sidoqoftë, disa shkrimtarë të shquar i kapërcenin dhe u shmangeshin këtyre të metave me talentin e tyre si p.sh. E. Bronteja, Dikensi, etj. Ndërsa disa u kundërviheshin me qëndrimin e tyre parimor, human, fisnik dhe me strukturën artistike të veprës si p.sh. Thekëri, Xh. Elioti, etj. (Daiches, 1049-1050; Albert, 367-375).

Megjithëse kjo periudhë është periudha më e madhe e letërsisë angleze, ka mendime se romani anglez në krahasim me romanin francez dhe të disa letërsive të tjera është më empirik dhe amatoresk. Si për mbarë letërsinë viktoriane, ashtu edhe për romanin viktorian vlen të thuhet se toni dhe fryma e këtij romani ishte një lloj simbioze dhe pleksjeje e elementeve romantike dhe realiste. Ndërsa poezia zakonisht është e prirë të arratiset nga jeta, romani tërësisht është i orientuar për t'u marrë me jetën e përditshme dhe bashkëkohore. Ky orientim, nuk është vetëm përshkrues por është edhe tematik: shumë shkrimtarë merren me problematikën aktuale shoqërore

dhe ideologjike, prandaj kritikojnë, predikojnë dhe bëjnë përpjekje që t'i korrigojnë dhe t'i përmirësojnë telashet, të metat dhe të këqijat shoqërore.

Si rrjedhojë, u shkruan edhe mjaft romane që sillnin porosi, apo romane me propaganda të ndryshme, gjë që ishte e natyrshme në periudhën e një liberalizmi dhe optimizmi të madh. Por, nëse romani ishte kryesisht realist dhe kritik, procedura letrare nuk ishte kurrë plotësisht realiste, ashtu siç e kuptonte Floberi realizmin. Prandaj në romanin anglez ishin të pranishëm shpeshherë elementet sentimentale, melodramatike, idealizimet, karikatura, komentit i autorit, recetat moralizuese e reformuese të autorit, etj. Në letërsinë angleze nuk është shkruar pothuajse kurrë ndonjë vepër e realizmit doktrinar, ndonse romani anglez që nga D. Defoi ka qenë në bazë roman me elementet e realizmit dhe të natyralizmit.

Sikur të donim të bëjmë një klasifikim të romanit anglez të kësaj faze, do të vërenim se lloji më i rëndësishëm i romanit ishte ai roman që shtjellonte tematika shoqërore dhe psikologjike (Xh. Ellioti). Një numër tjetër i veprave mund të emërtohen edhe si romane pikareske/aventureske. Mirëpo romanet e tilla kanë pak vlera letrare dhe artistike. Ekziston edhe romani historik, por tani ky lloj i romanit ishte i dorës së dytë. Skoti nuk pati ndonjë romancier trashëgimtar, sepse shkrimtarët dhe lexuesit tani i drejtoheshin bashkëkohësisë. Mirëpo, meqë të gjithë shkrimtarët merreshin me disa lloje romanesh, ngaqë ndonjëherë romancieri përzierte disa lloje elementesh të romanit, e mira e më së mirës do të jetë që t'i përmendim autorët kryesorë. Tashmë ekziston një mendim i përgjithshëm se tre shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit XIX të romanit anglez janë Dikensi, Thekëri dhe Xhorxh Ellioti. Çmohen mjaft edhe vlerat e romaneve të motrave Bronte, romanet e Hardit dhe të disa autorëve të tjerë të kësaj periudhe.

## Referencat

- [1]. Albert, E. A. History of English Literature, Hong Kong, 1985.
- [2]. Daiches, David. A Critical History of English Literature, Volume II, London, Secker and Warburg, 1963.
- [3]. Damrosch, David Ed., The Longman Anthology of British Literature, New York, Addison Wesley Educational Publishers Inc., 2003.
- [4]. Day, S. Martin. History of English Literature from 1837 to the Present, Doubleday and Company, New York, 1964.
- [5]. Ford, Boris. The New Pelican Guide to English Literature: from Dickens to Hardy. Pelican, Penguin Books, 1973.
- [6]. Hay, Douglas. Albion's fatal Free, Crime and Society in Eighteenth Century England, New York, Pantheon, 1975.
- [7]. Kadija, Refik. "A History of English Literature of the 19<sup>th</sup> Century – The Romantic Movement and Victorian Age," Shtëpia Botuese CAMAJ-PIPA. Shkodër, (në process botimi, 2013), 220 faqe.
- [8]. Legouis, Emilie. A Shory History of English Literature, The Clarendon Press, Oxford, 1978.
- [9]. Long, William. English Literature, Ginn and Company, London, 1972.
- [10]. Pollard, Arthur (1965). *Mrs. Gaskell: Novelist and Biographer*. Manchester University Press. p. 12. ISBN 0-674-57750-7.
- [11]. Pollard, Arthur. The Victorians, The Penguin Books, London, 1993.
- [12]. Sampson, George. The Concise Cambridge History of English Literature, Second Edition, Cambridge, At the University Press, 1961.